

**ESMERALDA PATOSHI (SEFA)**

**LIDHËZAT BASHKËRENDITËSE KËPUJORE TE PJETËR  
BOGDANI**

Nga ana gramatikore lidhëzat janë studiuar gjerësisht. Këtu po përmendim punimet për lidhëzat të Spiro Floqit, Mahir Domit, Emil Lafes etj. Tekstet e vjetra kanë rëndësi, pasi janë visari i gjuhës së shkruar. Çdo tekst i vjetër është një gur mbi themelin e gjuhësisë shqipe. Është e domosdoshme studimi i tyre pasi me to nis dokumentimi i gjuhës sonë. Nga pikëpamja e historisë së gjuhës shqipe, e periodizimit të saj, qoftë mbi kritere gjuhësore, qoftë mbi kritere historiko-gjuhësore, tekstet e vjetra shqipe, letërsia e vjetër shqiptare do të shënojnë gjithmonë hapjen e një epoke të re me rëndësi të jashtëzakonshme për gjuhën dhe kulturën tonë. Me veprat e letërsisë së vjetër shqiptare hapet epoka e gjuhës letrare shqipe. Gjuha shqipe radhitet tashmë krahas gjuhëve të tjera të Europës me një letërsi të shkruar, duke u zbutur në një farë mënyre ajo situatë paradoksale e kontradiktore, e krijuar nga fakti që gjuha shqipe, një nga gjuhët më të lashta të Europës, përfaqësuese e vetme e një qytetërimi origjinal, krejtësisht brenda sferës së kulturave të mëdha të botës antike, kulturës greke dhe romake, kishte mbetur deri në shekullin XV një gjuhë vetëm e folur, ende e pa dokumentuar me shkrim ashtu si edhe ndonjë gjuhë tjetër e vjetër e Ballkanit, siç ishte rumanishtja, e dëshmuar afërsisht në të njëjtën kohë. Mosnjohja e një tradite më të hershme (dëshmia e vonë) sjell paqartësi, mangësi në gjuhësi, prandaj duhet studiuar çdo tekst i letërsisë së vjetër. Letërsia e vjetër shqiptare duhet vështruar jo vetëm si një pikënisje e sigurt për të ndjekur evolucionin e brendshëm të dukurive të ndryshme gjuhësore që nga shekulli XVI deri në ditët tona, por edhe si pikëmbërritje e fazave më të hershme, si një bazë e njohur për t'u ngjitur e depërtuar në fazat më të hershme më pak të ndriçuara të gjuhës. Për të mbyllur vlerësimin e përgjithshëm për tekstet e letërsisë së vjetër shqiptare do të thoja se rëndësia e tyre për historinë e gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi është e pazëvendësueshme. Të njohësh të shkuarën është kurdoherë e dobishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë të tashmen edhe në fushën e studimeve gramatikore. Një nga detyrat që duhen përmbushur për të zhvilluar më tej studimin sistematik të gjuhës shqipe në përgjithësi e të gjuhës letrare në veçanti në këto vite është studimi i gjithanshëm i gjuhës, një studim i tillë i duhet bërë veprës së Pjetër Bogdanit, si një nga veprat e vjetra të letërsisë shqipe. Për gjuhën në veprën e Bogdanit nuk është shkruar pak, por struktura morfologjike e sintaksore e saj nuk është

përshkruar ende në një mënyrë të plotë dhe sistematike. Një nga çështjet që meriton të trajtohet e të studiohet më me imtësi është edhe ndërtimi e funksioni i lidhëzave. Pasi deri më sot vëmendja e gjuhëtarëve që janë marrë me studimin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe, si nga plani sinkronik, si nga plani diakronik, është tërhequr më shumë nga pjesët emërtuese të ligjëratës se sa nga ato të ashtuquajtura pjesë shërbyese. Në fakt këto pjesë shërbyese kryejnë në gjuhë shërbime shumë të rëndësishme, prandaj pa njohjen dhe studimin e gjithanshëm e të thelluar të tyre, nuk mund të bëhet një përshkrim i qartë e i plotë i sistemit gramatikor të gjuhës së sotme ose të shekujve të shkuar. Edhe pse që prej kohës së prof. Aleksandër Xhuvanit, i cili la një punim të plotë për parafjalët<sup>1</sup>, studimi për pjesët shërbyese të ligjëratës ka ecur, mbetet akoma për të studiuar. Duke ditur si paraqitet kjo pjesë e ligjëratës, lidhëza, te libri i Bogdanit, mund të kuptojmë më mirë se si është zhvilluar sistemi i pasur e i zhdërvjellët i mjeteve lidhëzore që ka gjuha e sotme letrare. Në veprën e Bogdanit hasim një lëndë të pasur për të hetuar mënyrën dhe fazat e formimit të lidhëzave të përngjitura e të lokucioneve, gjithashtu edhe për të parë zhvillimin e kuptimeve të tyre në shekujt e mëpastajmë.

Në 367 faqet e veprës së Bogdanit dalin 84 lidhëza (të thjeshta, të përngjitura e lokucione), ku disa prej tyre përdoren me dy a më shumë kuptime. Po t'i numërojmë këto të fundit si fjalë të veçanta për çdo kuptim që mund të kenë, atëherë numri i përgjithshëm i lidhëzave arrin në 97, por disa prej tyre përdoren vetëm nga njëherë, ndërsa të tjera nga më shumë se dy herë.

Ky punim u hartua duke u mbështetur në vjeljen shteruese të lidhëzave që dalin te vepra e Bogdanit dhe duke analizuar një për një të gjitha përdorimet e tyre, duke iu referuar edhe veprës origjinale. Metodën që do të ndjek gjatë këtij punimi janë: përshkruese, argumentuese dhe krahasuese, duke i ndërthurur këto tri metoda do të mund të analizojmë lidhëzat te Bogdani ashtu siç duhet. Për të studiuar lidhëzat në veprën e Pjetër Bogdanit kam zgjedhur transkriptimin e Anila Omarit. Shembujt që janë marrë gjatë punimit janë nxjerrë pikërisht nga ky transkriptim.

Gjatë këtij punimi synoj të arrij në disa përfundime lidhur me lidhëzat në veprën e Pjetër Bogdanit, përfundime nga ana sintaksore, duke ngritur një gur tjetër mbi historinë e gjuhës shqipe, pasi për të kuptuar se si është gjuha sot na nevojitet të shohim se si ka qenë në fillimet e saj, si ka evoluar deri më sot, ç'ndryshime ka pësuar ajo etj. Mendoj se punime të këtij lloji duhet të bëhen për të gjithë autorët e vjetër në mënyrë që gjuha të studiohet hap pas hapi në mënyrë sinkronike e diakronike.

<sup>1</sup> A. Xhuvani, *Parafjalët, Studime filologjike* nr. 1, 1964, f. 7-59.

Studimet gjuhësore në çdo gjuhë nisin nga faza e dokumentuar e saj, prandaj është e rëndësishme të bëhet studimi i çdo vepre të letërsisë së vjetër, duke nxjerr veçoritë gjuhësore të tyre e duke njohur traditën e hershme shkrimore të gjuhës së shkruar shqipe, në mënyrë që të kuptojmë evoluimin që ka ardhur deri në ditët tona.

#### **Klasifikimi i lidhëzave sipas funksionit sintaksor**

Nga pikëpamja e funksionit sintaksor lidhëzat ndahen në dy grupe: *në lidhëza bashkërenditëse dhe në lidhëza nënrenditëse*.

Lidhëzat bashkërenditëse shprehin raporte barazie, shërbejnë për të lidhur dy gjymtyrë ose dy fjali të një fare (të dyja të pavarura, kryesore ose të varura). Lidhëzat nënrenditëse shprehin raporte varësie, shërbejnë kryesisht për të lidhur një fjali të varur me fjalinë drejtuese të saj. Lidhëzat bashkërenditëse ose lokucioni lidhëzor përkatës mund të dalë ndonjëherë edhe në krye të periudhës ku bën pjesë, por e lidh të tërë këtë periudhë me periudhën që ndodhet para saj.

Si rregull, një lidhëz është ose bashkërenditëse, ose nënrenditëse, por ka edhe raste kur ndodhin kalime nga njëri grup te tjetri. Kështu, për shembull, lidhëzat nënrenditëse kohore ndërsa e teksa në disa kontekste të caktuara janë shndërruar në lidhëza bashkërenditëse me kuptimin përqsor-kundërshtor, kurse lidhëza këpujore edhe është shndërruar në lidhëz nënrenditëse lejore.

1. Lidhëza bashkërenditëse. Sipas llojit të marrëdhënieve që shprehin, lidhëzat bashkërenditëse ndahen në lidhëza këpujore, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse dhe të shkallëzimit.

a) Lidhëza këpujore janë: *e, edhe, dhe, ende, as, mos*, përdoren të përsëritura lidhëzat *as, dhe*, edhe: *as....as, dhe....dhe, edhe....edhe*.

Lidhëzat këpujore janë lidhëza tipike bashkërenditëse. Ato shprehin një bashkim të thjeshtë gjymtyrësh ose fjalish të një fare. Lidhëza *as* ka kuptim mohor dhe, e përsëritur e përforcon këtë kuptim. Nga të tria lidhëzat këpujore sinonimike *dhe, e, edhe, ende*, më e përdorshmeja si në fjali, ashtu edhe në periudhë, është *e*-ja, ndërsa lidhëzat *dhe, edhe* përdoren më pak, më rrallë. Megjithëse sinonimike, këto lidhëza nuk mund të përdoren lirisht në vend të njëra-tjetrës.

b) Lidhëza veçuese janë: *a, o, ose, ndo, herë... herë, qoftë ....qoftë*. Lidhëzat *o* dhe *ose* mund të përdoren edhe të përsëritura *o...o, ose....ose*. Këto lidhëza tregojnë se fjalitë ose gjymtyrët e lidhura me anë të tyre përjashtojnë njëra-tjetrën (d.m.th. vetëm fakti i njëjës prej tyre mund të ndodhë) ose ndërrohen njëra me tjetrën.

ç) Lidhëza kundërshtore janë: *ma, po, veç, veçëse, megjithë, kurse, ndërsa, përveç*. Këto lidhëza shprehin marrëdhënie kundërshtore, përqsore-kundërshtore ose kundërshtore-kufizuese midis gjymtyrëve a fjalive që lidhin.

d) Lidhëza përmbyllëse *prandaj, andaj, ndaj*. Fjalitë ose gjymtyra para së cilës ndodhen këto lidhëza, tregojnë diçka që është si përfundim, si pasojë e

asaj që është thënë në fjalinë a në gjymtyrët e mëparme. Këto lidhëza kanë përgjithësisht kuptim ndajfoljor, por në vepër ato shërbejnë si mjet lidhës.

e) Lidhëza të shkallëzimit *jo veçë... po; jo veçëse.....po; jo veçë posi* etj. Këto lokucione, që mund të lidhin si fjali, ashtu edhe gjymtyrë fjalish, përdoren zakonisht me vlerë këpujore e më rrallë me vlerë kundërshtore. Por kryesorja në semantikën e këtyre lokucioneve është theksimi i fjalisë ose gjymtyrës së dytë që lidhin, e cila paraqitet si më e rëndësishme se e para. Në këtë mënyrë, midis dy fjalive a dy gjymtyrëve, qofshin me marrëdhënie këpujore ose kundërshtore, vendoset një marrëdhënie e re shkallëzimi. Për këtë arsye ato përbëjnë një grup të veçantë të lidhëzave bashkërenditëse. Këto lidhëza janë më të reja se llojet e tjera të lidhëzave bashkërenditëse, por sot përdoren mjaft dendur.

#### **Lidhëzat bashkërenditëse këpujore**

Lidhëzat bashkërenditëse këpujore që gjejmë te vepra e Bogdanit janë këto: *e, edhe, dhe, ende, as, mos* (nga këto katër të parat kanë kuptim pohor, ndërsa dy të dytat kanë kuptim mohor) dhe lokucionet *jo veçë..... po, jo veçëse..... po*. etj.

Lidhëza **e** është fjala që ka denduri më të madhe në veprën e Bogdanit. Ajo është përdorur gjithsej 3494 herë. Arsyja e një dendurie kaq të lartë duhet kërkuar te veçoria e stilit Biblia, që siç dihet, i parapëlqen shumë ndërtimet parataktike me këtë lidhës. Por shqipja e kësaj periudhe veç lidhëzës e ka pasur edhe një lidhës tjetër sinonimike me të: edhe, e cila është përdorur veç katër herë. Pra po ta shohim denduria e lidhëzës **e** te Bogdani është shumë herë më e lartë se denduria e lidhëzës **edhe**. Kjo gjë na bënë të pohojmë se ky raport pasqyron në thelb një veçori edhe të shqipes popullore të asaj kohe. Në këtë vepër ne hasim përdorimin edhe të një lidhëze tjetër siç është lidhëza **et**, kjo lidhës është përdorur 25 herë.

Përdorimin e lidhëzës **e** dhe të gjithë lidhëzave bashkërenditëse do ta shikojmë së pari në fjali e pastaj në periudhë. Në fjali lidhëza **e** shërben për të bashkuar dy gjymtyrë homogjene: kryefjalë, kallëzues, kundrina, plotës etj. p.sh. *Jetet së jetësë të vinte roe bukurinë e të madhit e t'naltit vet. Përse tjetër ashtë aj kahë len e aj qi len. Tue mos pasunë asndonji këso gjashtë punësh Muhameti, për asndonji mëndyrë mundetë e duhetë me i thanë profetë. Mbëlidh muej gjithë Izraelnë mbë mal të Karmelit, e profetët'e Balit 450 e profetshsë prozhmesh 400 qi jesënë e hanëmë tryezë të Jexabelit. Kisha e t'këqijvet, e këshu gjithë të pafetë janë gjymtyrët'e djallit,e aqa i shtërgon n'veti djalli të përkatënuemit e të pafetë. E derdhi gjarpëni gojet e gryket së vet ujë posi lum etj.*<sup>2</sup>

<sup>2</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 1-50.

Lidhëza e mund të bashkojë edhe dy gjymtyrë johomogjene (p.sh. plotës kohe e një plotës vendi): *E jo për zakon e dokë. Mali i Tënëzot e vendi shejti tinaj e vendi shëkrimit, e udha shejte. E bijat e mia prej anet së dheut, e gjithë ata, e ngushëllimnë tem. David profeta i parë, e kryet e gjithë profetëvet,* por bashkërenditja këpujore e këtyre gjymtyrëve shpjegohet me anë të një elipse logjike të kallëzuesit, si pasojë e së cilës lidhëza e ka dalë ndërmjet një plotësi kohe e një plotësi vendi.

Duke e parë tani lidhëzën e në periudhë, duhet të mbajmë parasysh se lidhëzat këpujore japin vetëm idenë e lidhjes në mënyrën më të përgjithshme, më të padiferencuar, më abstrakte dhe prandaj lloji i marrëdhënieve midis dy fjalëve të bashkërenditura këpujore varet nga përmbajtja reale e tyre e jo nga lidhëza.

Lidhëza e mund të bashkojë dy a më shumë fjali bashkërenditëse, që kanë ndërmjet tyre:

1- Marrëdhënie thjesht këpujore: *Pra kur ndër kafshë të kësaj jete shqiset' e nierit thenenë, lëndohenë. Nji pjesë njoftëmë e një pjesë ndivënejëmë. Andaj për tu njimendunë me të Shkruemit Shejt e për të forçuem të dërejtënë thotë Shë Atanasi. Besoj Abrami e ju mbajti për të madhe të dërejtë. Tue kjnë ndë të parët ligjëratë mejaft çelë e me arrësenje të forta kallëzuem. Të sijtë aj tue i pam u duel përpara e i adhëroj ndjerë mb'dhe. Tue i mbarsunë për të pjellë ani e për të bam peshkun e zojtë. Ngrhën nierinë mbë die e zotënon ujënatë e farënë. Hyji maltë i qiellit ashtë kruet' e kahë bunon e rrjedh të gjallëtë e të lëkundënit e kafshëve<sup>3</sup>.*

2- Marrëdhënie kohore. Këtu duhen dalluar a- fjali që tregojnë veprime që kryhen në të njëjtën kohë dhe b- fjali që tregojnë veprime që kryhen njëri pas tjetrit: *Ndritën rrethn e shekuulit, e natënë ndritën atë pjesë dheu. Kanë dvierrë Tënëzonë, e kurraj nukë kanë me pam. U bafshinë dritëtë mbë qiellt, e ndë çast duel jashtë dielli e hana. Ashtë shenji i kthielltë e i motit mirë, e kur jet unjëjtë përdhe. Fort u mrekuulluënë ata shejtënë Atë, tue ndiem kafshë kaqa të re, e kurraj ndjerë aso koheje gjegjunë.<sup>4</sup>*

3- Marrëdhënie përqsasjeje e kundërvënieje: *Ndër diellinë e hanënë hin qendrat dheu, e nukë lëshon hanënë me marrë dritet së diellit mbë zakont. Ujëjtë prej së nxitit së diellit holluem bahet shi, e për luftë të t'fotofëtit e t'nxitit bahetë breshënë e borë. Ban me dridhtunë dheu, e nukë ashtë e vërtetë përralla e t'pafeut. Aj njimend i përshpirçim mbë shembëlltyrë të engjijet, e nukë mundetë me bim prej nji korbi. Kanë me lypunë nierëzitet mortnë, e nukë kanë me gjetunë. Të këqijtë asgja kanë mbë qiellt, e ju asgja mbë këtë jetë. Së*

---

<sup>3</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 6-37.

<sup>4</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 30-37.

*dyjti për të dvue m të keqenë e për të nxitunë mbë të mirë. Thotë grue të vet, e nukë thotë me t'amën 'e vet.*<sup>56</sup>

4- Marrëdhënie shkak-pasojë ose kusht-pasojë: *U mëngjis lakëmia, e me të Pili të uthullësë me helm. U mëngjis grykësia, e me të rrafunatë qi duroj. Kjenë ujëna aqa të mëdha ndëpër gjithë shekullit, sa gjithë e mbytnë, e mbëluenë pak mos përnji motmot t'ungjinë, tue çofunë gjaja e gjallë, e mbytnë gjithë nierëzitë jashtë. Ma tjetëri dhe tue u larguen fejet e së mirash së prindet, ka pak ka pak u rrëzuenë ndë idhulatri, e me ta ndë gjithë duer së këqiasht.*<sup>6</sup>

5- Marrëdhënie qëllimore: *Me djersë të ballit tit ke me gjëllitunë e me zanë bukënë tande. Ma fëjej grueja, e për të tjera punë. Lypën fenë, e ka me ju bam ndihmë. Zotynë ndëpër mëshërie të vet kishte vum rok me çuem e me nalçuem natyrën e nierit. S. Agustini ban për shembëlltyrë atë dru, me të sijt Mojzësi preku ujënat e Maratit e i ambëltoj tue kjanë mpari fort t'idhuna, e i bani me i pim bijt e Izraelit.*<sup>7</sup>

Lidhëza e te Bogdani përdoret edhe në konstruktet që përmbajnë një enumeracion, të cilët janë mjaft të shpeshta në stilin e shkrimit të shenjtë: *Mali i Tënëzot e vendi shejti tinaj e vendi shëkrimit, e udha shejte.*

*E bijat e mia prej anet së dheut, e gjithë ata, e ngushëllimnë tem. Shëlbuesi em ashtë gjallë, e ditet së mbrame dheut, e së dyjti, e ndë mishtë tem, kam me pam Shëlbuesinë tem. Këto punë flet Zotyni i ushtërivet: ende pak ashtë, e unë kam me lekundunë qiellnë, e dhënë, e dëtinë, e të thatitë.*

*E aty plot me shejtëni të gjëllinjë e të punojnë hjithë sa duhej pr atë shejte kishë, e me njinesë e me uratë e të tjera shejte. E ta mbaj gjall me fëtigë të tinaj, e të kish kujdes shtëpinë e pronët e prindet. Fort u idhënuë, e përditë tu i ardhunë keq ma fort.*<sup>8</sup>

Një tjetër veçori e gjuhës së Pjetër Bogdanit që ka të bëjë edhe me stilin biblik në përgjithësi, është përdorimi i gjerë si telnyj. *Siç ka vënë re edhe Shçerba, lidhëzat bashkërenditëse mund të përdoren edhe me një funksion tjetër, në atë rast ato nuk i bashkojnë këto ose ato elemente në një të vetme, por vetëm i "pranëbashkojnë" te elementi paraardhës. Ndryshe nga rasti i lidhëzave bashkërenditëse, kur "të dyja gjymtyrët janë të pranishme në vetëdijen tonë, qoftë edhe në një formë të trubullt, që në fillim të të folurit, në këtë rast elementi i dytë shfaqet në vetëdije pas të parit ose në kohën e shprehjes së tij. Nga pikëpamja formale ky dallim funksioni shprehet me anë të theksit të frazës, nganjëherë me anë të pauzës dhe në përgjithësi me anë të*

<sup>5</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 28-46.

<sup>6</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 47-53.

<sup>7</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 47-53.

<sup>8</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 70-158; ÇP, II, f. 8-15.

*intonacionit*<sup>9</sup>. Konstruktet me fjali shtesore janë mjaft karakteristike për stilin biblik. Lidhëza *e* në këtë rast vë njërin pranë tjetrit e i bën, si të thuash, varg fakte të ndryshme që dalin shkallë-shkallë në vetëdijen e folësit, p.sh. *Tue mugulluem, ka me mugulluem poai lilji, e ka me u ngushlluem për t'u gëzuem, e për t'u lëvduem. Ndërsa po mbaj të heshtunitë gjithë kafshët, e nata ndër vrap të vet kishte bam gjymçën 'e udhësë, e pushtueshimeja fjala jote prej qiellshit regjëneshash selish së tuash. E nieri kje bam mbrenda sajnaj, e vetë i nalti e bani ata. Gjegj S. Jozefi, e për një si u que ndëpër ata terr të natës, u da me djalit e me t'amët, e muer udhënë prej Misiri. Kur Jezu Krishti hini ndë Misirt gjithë ata idhujë, të sijtë kjenë të panjehunë ndëpër ata regjëni, e durësh e drush adhëroheshinë, dridhtinë; e gjithë mb'dhe u rrëzuenë. Tue kjanë ndë këto ligjëratë, nje e mbërrini regjëneshë e qiellsë, e lumja Virgjinë Mri., bashkë me të S. Jozefit. Ajo ndë çast lëshoj sytë mbë bir të vet, e vote prej si pa manesë 'e muer ngrykë, e shumë herë e puthi, e i tha.*<sup>10</sup>

Të tillë shembuj ka në të gjithë veprën e Pjetër Bogdanit, gati në çdo faqe të veprës së tij. Ndoshta nën ndikimin e këtij lloji stili, në disa pjesë të veprës Bogdani ka ndërtuar në pjesën më të madhe fjali e periudha që nisin me lidhëzën *e* të përdorur me vlerë shtesore p.sh.: *E silla ashtë këjo dije jashtë asaj së naltit Zot, për të sillt thotë Salamoni. E lumeja Virgjinë Mri, për një si hini gjithë tue i shkuem. E lumeja Virgjinë Mri gjithëherë droj, e kurraj nukë uzdatej. E me të madh dëshir tue kujtuem: nje Engjëlli Gabriel hini ndëpr atë balkue. E çprishi një tremek. E treta mrekulli kje Piramida e Misirit: ndë trajtim të mrekullueshim të sajnaj kjenë. E pa me kunorrë ferrash, i pa faqen 'e tinaj. E ndjeu e lumja Virgjinë, e thonë se depërtoj ndëpër ata të përzieme gjind.*<sup>11</sup>

Pak herë lidhëza *e* është përdorur si pjesëz përforcuese me kuptimin edhe (shih në vazhdim, më poshtë në faqet në vijim): *E ky krue i gjallë e këta të kjanë të amëshueshim për të njimendë ashtë Huji krijues,....; E shpirti t'ndëgiuemit tim ka me më përgjegjunë mue,....; Së shtati me kallëzuem vetëhenë e kafshët e mbëluemë:....; E ujënat ma të trasha ndënë qiellit mbetnë,....; E ma të shumë të dotorë thonë se.....; E korpënat 'e qiellit pianetëtë e yjtë apënë vërtyt e forçë gjithë kafshëvet me u lëkundunë,...*<sup>12</sup>

Disa herë është vështirë të thuhet për një *e* nëse është lidhëz apo trajtë e shkurtër përemërore. Kjo ndodh në ato raste kur në vend të një *e*-je që ka Bogdani, duke pasur parasysh dhe natyrën e shqipes, pritej të kishim dy *e*, prej të cilave e para të ishte lidhëz kurse e dyta të ishte trajtë e shkurtër përemërore. Por në këto raste kemi rënie të një *e*-je pranë një tjetre kështu që

<sup>9</sup> L. V. SHÇERBA.

<sup>10</sup> P. Bogdani, ÇP, II, f. 18-35.

<sup>11</sup> P. Bogdani, ÇP, II, f. 4-114; ÇP, I, f. 3-22.

<sup>12</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 1-27.

hasim vështirësi si p.sh.: *e tue shpum; tue marrë vesht; ke me falë; e Lijsë sanë; tue adhëruem; me rritunë, tue shtim, tye pas rritunë, tue përgëzue, tue shkelë, me ngranë, tue shtim, tue prekunë, me pam; me paditunë, me vram*<sup>13</sup>. E. Çabej duket se i mban këto *e* më fort për trajta të shkurtra përemërore sesa si lidhëza<sup>14</sup>. Në të vërtetë, në shembujt e mësipërm, sipas natyrës së shqipes, janë po aq të domosdoshme si lidhëza ashtu edhe trajta e shkurtër përemërore<sup>15</sup>. Lind pyetja si shpjegohet që ka vetëm një *e* në vend të dyve? Duke pasur parasysh që është një përkthim, ne besojmë se në punë e sipër, Bogdani mekanikisht ka shkruar një *e* sa herë që ka parë një *et* ndoshta në origjinal, të cilën *e* ka ndjerë njëkohësisht edhe si një trajtë të shkurtër që shprehë kundrinën e drejtë. Duke qenë se jemi shkrimet e vjetra përkthimi nuk mund të ishte perfekt, nuk janë të papritura edhe gabimet. Nuk përjashtohet as rasti i lënies jashtë nga ana e vet Bogdanit të një *e*-je, në rastet kur do të mblidheshin me një vend tri të tilla, ku të kishim lidhëzën, trajtën e shkurtër përemërore dhe fjala në vazhdim të fillonte me *e* si p.sh.:

*ndë të njehunit e të madht e e t'shejtit pagëzimit tinë.*<sup>16</sup>

Por ajo që na bën të besojmë edhe më fort se mungesa e një *e*-je pranë një tjetre te shembujt në fjalë ka karakter subjektiv, është fakti se në disa raste Bogdani nuk ia ka lejuar vetes këtë gabim dhe ka shkruar fjalë me të tria *e*-të si: *e e adhëroj ndjerë mb'dhe ,...;....e e thonë burrënia.; fort udob e e amblë,....*

2- Fjala **edhe** është përdorur si lidhëz vetëm 4 herë p.sh.: *Ky zot fort i urtë më dha fort zemërë me votë paret ndë këtë vepërë, ende tue më ndimuem pakuer fort ndë shumë fjalë t'arbënasha, të siatë i kish udob e për duer, tue pasunë bam edhe aj një gramatikë fort të godiçme latin e shqip..... Përveç emrave të zakonshëm, mbajnë edhe emra vendesh nga ato krahina. Kështu Sibila Delfike, qëndodhet në qendër të gravurës, quhet edhe Hasnjana. .... Si dhe t'ia transmetosh edhe vetë ipeshkvit të Shkodër,....*<sup>17</sup> Pak herë Bogdani ka përdorur lidhëzën **edhe** siç e shohim edhe nga shembujt. Më shumë ai përdor lidhëzën **ende** me kuptimin e lidhëzës **edhe** ku del edhe si pjesëz përforcuese.

3- Fjala **ende** te Bogdani del 277 herë. Në disa raste ka kuptimin e një lidhëze këpujore në disa të tjera del si pjesëz. Kjo lidhëz përdoret gjerësisht si

<sup>13</sup> P. Bogdani, ÇP. I, f. 61-87; mungesë e trajtës së shkurtër të përsëritur të kundrinës për shkak të rënies së një *e*-je pranë një tjetre në gjuhën e folur.

<sup>14</sup> Këtë përdorim të *e*-së E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe-dorëshkrim*.

<sup>15</sup> Siç ka vënë re J. Rrota, *Monumenti ma i vjetri i Gjuhës Shqype*, ashtu edhe autori ynë P. Bogdani e përgjithësisht të gjithë autorët e vjetër nuk e përdorin pleonazmin.

<sup>16</sup> P. Bogdani, ÇP. I, f. 12-29; ÇP. II, f. 44-20.

<sup>17</sup> P. Bogdani, ÇP. I, f. 156.

lidhëz këpujore në vend të lidhëzës edhe. Del si lidhëz këpujore në këto raste: *I silli tue u rritunë Jezu Krishti ende aj rritej ndjerë.... Mbëlonte pakëzë ballëtë, kështu ende e shkruen i S. Luka, ... Bora ashtë aqa e ftofëtë, sa tue e soditunë nieri, ende mbë maj të Ljubotenit..... I nalti Hyji qiellët desh ende me dërguem engjëllinë Gabriel për të dhanë atë të gëzuem..... Mbë gasët ende të Jakobit ndë kryj të Krishtit, ... Kështu endemsoj Krishnë Jezu birrë vet me u falë ndë jetë të tinaj...votë ende me i shërbyem.....*<sup>18</sup>

Del si pjesëz përforcuese lidhëza **ende** ne raste të tilla si: *...letërarëtë e dijera lulëzon ende shejteja fe,.... Ende Jezu Krishti pat një engjëllë posi thotë:....; Të gjashtë ditë tha ende Hyji:....; Këjo gasë ndër mendt duketë ende ndë shembëlltyrët ....; ....qi mbë qiellt ende mbë dhet të jetë i ngushëlluem.*

*Del edhe me kuptimin kohor akoma: E anëmiyt e sajnaj ma të mbëdhejtë ende nukë mujtinë me i ram mboh kësaj së vërtetë. Ashtu vepëratë, ashtu jeta, ashtu hiri, banu ende ashtu, qi të mundish të lidhunitë me xgidhunë... kryet ende e kish foro të lig ndëpër të theruna të mërqinjavet, ...tue pasun'ende aty atë dëshir të prapështë....., asgjamangu u u gjetnë ende përpara Krishtit nierëz....*<sup>19</sup>

4- Lidhëza **as** në librin e Pjetër Bogdanit është përdorur rreth 100 herë, por në gjysmën e këtyre rasteve ajo ka kuptimin e një pjesëze përforcuese mohore. Kur përdoret si lidhëz në periudhë, as ka gjithashtu edhe kuptimin e një pjesëze që përforcon mohimin. Lidhëza as shërben si për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie ashtu edhe dy fjali, p.sh.: *As patnë qish mirrinë me vetëhe për udhë kaq gjatë; as u dhimpte zemëra. Davidi as tha se Zotynë ashtë i besësë ndë gjithë fjalë të tinaj? As e dini se më duhetë me mbushunë vollëndetn'e Atit tim. As më ton qish ashtë ma udob me thanë. Të siatë kurraj syu nuk i ka pamë, as Mendía kujtuem. Kurraj nukë kanë me dekunë, as kanë me ndjemë ndonji mund. Kurraj nuk' ashtë kjanë së zanit së shekullit ndjerë m'tash, as kurraj nukë ka me u bam. Nukë ka dekunë për tu çprishunë, as ka me u pakuem mishi. Hyjënja kurraj së dysh nuk'u da, as shpirtit as mishit. Nukë jam, as e njoh, as dij grue qish po flet. Nukë mundej me pamë, as me u fshim.*<sup>20</sup> Në një enumeracion lidhëza as mund të vihet edhe përpara fjalës së parë p.sh.: *As hana delte me dy të rgjanta bri, as prej qiellshit vinte ndonji rreze përdhe, as dheu si shqype nalt qëndron e rri, as niegullë me shi, as breshën'as rrëfe, as deti me vallë epte të madhe gjamë, as lymënatë me breg ishën zanë.*<sup>21</sup> Lidhëzën **as** te Bogdani mund ta gjejmë edhe si shtesore, zakonisht në periudhë po ndonjëherë edhe në fjali, p.sh. *Së tretet dorë*

---

<sup>18</sup> P. Bogdani, ÇP, II, f. 7-65.

<sup>19</sup> P. Bogdani, ÇP, II, f. 2-26; ÇP, f. 3-5.

<sup>20</sup> P. Bogdani, ÇP, II, f. 1-179.

<sup>21</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 20.

*nierëzish mbë tjetërët jetë janë ata qi nukë janë asta mirë si të parëtë, as të këqij posi të dyjtëtë. Aty tue u bam bashkë, s'mundinë as me hipunë ndëpër të randa të tyne, as me zdripunë ndëpër të lee të vet. E djalli vetëhej nukë mundote, as pak, as shumë. As me këtë të katërtënë kallëzim u pendue Faraóni. As për këtë të keqe u kthye Faraón. As s'u ndërrue Faraón së këqiashtit së vet...qi përpara ty, as mbas këndajnaj mbas teje ka me lem, as ka me të gam,....<sup>22</sup> Siç thamë edhe më sipër, në numrin më të madh të rasteve kjo lidhëz gjendet si e përdorur si pjesëz përforcuese mohuese. Ajo është antonim i pjesëz **edhe-ende** që trajtuam më sipër. 5- Lidhëza **dhe** te vepra e P. Bogdanit haset si lidhëz shtuese që lidhë dy fjali a dy periudha. Ajo është përdorur 14 herë si: *Ne të liruam nga detyra kur ti atëherë drejtoje kishën e Ohërit, detyrë që e more pas këshillës së vëllezërve tanë dhe në përputhje me dëshirën apostolike, dhe me të njëjtën këshillë e autoritet apostolik, të transferian në kishën metropolitane të Shkupit. Ne, duke dashur që së pari të kihen në konsideratë shëndeti dhe mirëqënja jote dhe duke dashur të të pajisim me favore e me ndere të posaçme, dhe, në rast se ti rezulton në një farë mënyre i prekur nga dënime kishtarë që kanë të bëjnë me shkishërimin. Kur të kesh marrë nga ati i nderuar, ipeshkëvi i Shkodrës stolën e lartpërmendur, që në bazë të letrës së më sipërme t'u çaktua ty, dhe mbasi prej duarve të tij do të kesh bërë betimin e zakonshëm në emër të besnikërisë ndaj SER, mbasi të kemi marrë betimin dhe deklaratën e më sipërme, ne japim leje që ju të mundni dhe të jeni në gjëndje ta ushtroni këtë autoritet simbas përmbajtjes së kësaj letre.<sup>23</sup> Siç vëmë re kjo lidhëz nuk ka një përdorim të madh, në disa raste ajo zëvendësohet edhe me et. Nga shembujt që pamë më lart duket qartë përdorimi i saj si lidhëz me kuptim shtues. 6- Lidhëza **mos**. Një veçori e gjuhës së Bogdanit është përdorimi i fjalës mos si lidhëz me kuptimin "as" Me këtë kuptim fjala mos është përdorur 25 herë. p.sh.: *Mos u vinja keq vëllazënit e mi, se të këqijrë mbë këtë jetë i lulëzojnë e ju pësoni'.... Thmë unë juve mos kini kujdes jetësë sajnaj. Prej Abramit do veçëse të gjegjunitë, tue i thanë: mos çari dorënë tande pët mbi djalit,... Po të kështenëtë, qi janë të vërtetë bij të përmetesësë të Abramit tue mos u damë kurraj fejet së njit vetmit Zot Tre pa, e një adhëroj... Mos druesh shërbetori em Jaçob, e foro i dërejti Israel, të sillënë xgova. Faraoni urdhënoj ndënë të marrë të kresë të mos i dal ma përpara.<sup>24</sup>***

### **Përfundime**

Duke e krahasuar sistemin lidhëzor të Bogdanit me sistemin lidhëzor të Buzukut e të gjuhës së sotme duket qartë se që në shek. XVII gjuha shqipe ka

<sup>22</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 34-111.

<sup>23</sup> P. Bogdani, ÇP, II, f. 179. Letra dërguar vëllait, Andrea Bogdani.

<sup>24</sup> P. Bogdani, ÇP, I, f. 43-102.

qenë e formuar në të gjitha rrafshet gjuhësore, por ka qenë në zhvillim e sipër, duke ardhur në ditët tona më e plotë. Nëse do të duhej të bëhej një studim mbi gjuhën është tepër e rëndësishme të shihet evolucioni i saj në planin sinkronik e diakronik të gjuhës. Nga libri i Bogdanit mund të nxirren të dhëna me interes për të hetuar kushtet e mënyrën e formimit të disa lidhëzave. Nëse do të kemi studime të tilla për të gjithë autorët e vjetër, studime në planin morfosintaktik, do të ndiqet hap pas hapi zhvillimi i strukturës së periudhës dhe i mjeteve lidhëse të shqipes që nga periudha e shkrimeve të para e deri më sot. Një detyrë e tillë është me rëndësi si për sintaksën historike ashtu edhe për historinë e zhvillimit të gjuhës letrare. Gjuha e veprës së P. Bogdanit (1625-1689) është e afërt me gegërishte e Buzukut, Budit e Bardhit, por më e lëvruar, më e pasur, më e pastër se ajo e paraardhësve të vet. Vepra e tij “Çeta e Profetëve” mbetet vepra e parë origjinale e prozës sonë, e ndarë në shkallë e ligjërata, në dy shtylla në çdo faqe. Veçori nga ana sintaksore ngelet përdorimi i disa lidhëzave, të cilat më themeloret janë trashëguar edhe sot, e disa të tjera që dalin vetëm të ky autor, si një veçori gjuhësore e tij. Në veprën e Bogdanit kategoria e lidhëzave paraqitet e pasur si me lidhëza të thjeshta e me të përngjitura, ashtu edhe me lokucione lidhëzore. Siç thamë më lart disa prej tyre kanë dal nga përdorimi e disa të tjerë kanë pësuar ndryshime. Megjithatë është me interes të thuhet se këto lidhëza e lokucione lidhëzore, që mund të duken pak a shumë si të reja, na dokumentohen shumë më herët. Për disa kategori lidhëzash bien në sy dallime të theksuara midis gjendjes së tyre te P. Bogdani dhe gjendjes së tyre sot. Siç shohim vepra e P. Bogdanit është tepër e rëndësishme për gjuhësinë tonë. Shohim evoluimin e të gjitha lidhëzave, kategori që te libri i parë shqip nuk janë ose disa kategori të tjera shfaqen të vakti, jo me të gjitha llojet e lidhëzave. Po ta vështrojmë edhe me Fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe vëmë re se shumë lidhëza janë edhe sot ashtu si në veprën e Bogdanit.

Proza e përpunuar e veprës së Bogdanit, me periudha të gjata, por të ndërtuara drejt, me lidhje sintaksore e logjike të brendshme që e paraqesin mendimin sa më të qartë, me një larmi mjetesh shprehëse ku bashkëjetojnë ndërtime të sintaksës popullore e dialektore me ato të një sintakse të përpunuar letrare, të gjitha këto e bëjnë veprën e P. Bogdanit një burim të rëndësishëm edhe për sintaksën historike të gjuhës shqipe. Shohim disa përdorime të lidhëzave te libri i parë shqip “Meshari” dhe te “Çeta e Profetëve”, në mënyrë që të shohim ndryshimet e tyre e duke nxjerrë në pah disa veçori të këtyre dy veprave të rëndësishme si për letërsinë ashtu edhe për gjuhësinë tonë. Në këtë punim pamë të gjitha kategoritë e lidhëzave, përdorimin e tyre, ndarjen sipas strukturës morfologjike e sintaksore, rëndësinë e veprës së Bogdanit për gjuhësinë e letërsinë tonë, krahasimet me librin e parë shqip “Meshari” dhe me Fjalorin e Gjuhës së sotme Shqipe, duke nxjerrë veçori të lidhëzave e duke arritur në përfundimin se, gjuha e P. Bogdanit ishte shumë më e pasur e më

zhërvjelltë se gjuha e paraardhësve të tij, duke qenë se ishte dhe libri i parë origjinal në letërsinë tonë. Mendoj se punime të tilla duhet të thellohen më tej edhe për autorë të tjerë të letërsisë sonë të vjetër, duke hedhur dritë mbi atë pjesë të gjuhësisë që është tepër e rëndësishme për ne dhe gjuhësinë tonë.